



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2 NËNTOR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2. NOVEMBRA 2015. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër

Dnevni red

1. Razmatranje Nacrt zakona o ratifikaciji Sporazuma o Stabilizaciji i Pridruživanju između Kosova, sa jedne strane, i Evropske Unije i Evropske Zajednice za Atomsku Energiju, sa druge strane

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Ahtifete Jahjaga,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike

Komisione për Integritime Evropiane e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj Bekim Çollakun, ministër i Integrimit Evropian, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BEKIM ÇOLLAKU: I nderuar kryetar Veseli,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar Kabinet qeveritar,
E nderuar zonja presidente e Republikës së Kosovës,
Kam nderin dhe kënaqësinë ta prezantoj para jush Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian paraqet hapin e parë dhe më të rëndësishëm të ndërmarrë deri më tani në rrugëtimin e Republikës së Kosovës drejt Bashkimit Evropian.

Pa dashur ta ekzagjeroj, rëndësia e kësaj marrëveshje për orientimin strategjik, politik dhe ekonomik të vendit tonë është jetike.

Kosova tani është e gatshme për t'i marrë përsipër detyrimet dhe t'i bëjë reformat e nevojshme për t'i përmbushur kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Pa dyshim, si rezultat i kësaj marrëveshje, fati i Kosovës dhe i Bashkimit Evropian do të jetë i lidhur më ngushtë dhe besoj fuqishëm se kjo është një e arritur e madhe, e drejtë dhe plotësisht në përputhje e interesin tonë shtetërorë për integritime euroatlantike.

Përfitimet nga kjo marrëveshje për qytetarët dhe për rrugëtimin e integrimit evropian të vendit tonë nuk përfundon me të hyrë në fuqi kjo marrëveshje, përkundrazi do të jetë hyrja në fuqi momenti kur do të fillojë puna e vërtetë e integrimit të vendit tonë dhe në fazat e mëvonshme do të manifestohen edhe përfitimet konkrete nga kjo marrëveshje.

Deri tani ne kemi zbatuar kritere dhe reforma të shumta dhe shpesh të dhimbshme, bazuar pothuajse vetëm në disa premtime të përgjithshme nga Bashkimi Evropian, me bindjen dhe besimin tonë që shteti ynë duhet të jetë anëtar i Bashkimit Evropian, nga ky moment e tutje këto reforma do të bëhen me një qëllim të qartë dhe të pajtuar nga të dyja palët.

Por, të kthehemi një hap prapa dhe të kujtojmë edhe një herë pse po e bëjmë këtë. Pse po e bëjmë këtë marrëveshje me Bashkimin Evropian? Pse qytetarët e Kosovës me entuziazëm dëshirojnë ta shohin vendin e tyre në Bashkimin Evropian? Cilat janë arsyet dhe faktet që na kanë sjellë deri këtu? Arsyet mendoj janë të qarta për të gjithë ne dhe për të gjithë ju, gjithashtu.

Vlerat e Bashkimit Evropian janë vlera të cilat qytetarët e Republikës së Kosovës i kanë përqaftuar me kohë. Janë vlera të cilat qytetarët e Kosovës i konsiderojnë si vlera të tyre. Prandaj, kemi vendosur që t'i përqafojmë këto vlera dhe ta japim kontributin tonë solid që këto vlera t'i çojmë bashkërisht përpara.

Marrëveshja për Stabilizim-Asociim i ngërthen në vete të gjitha këto që i thashë. Ajo do të sjellë një motiv dhe shtyrje dhe obligim të ri për t'i zbatuar reformat që aq shumë i duhen vendit tonë, duke filluar nga përforcimi i mëtejme i sundimit të rendit dhe ligjit, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit deri te reformat ekonomike, me qëllim të rritjes së vendeve të punës dhe rritjen e këmbimit tregtar me Bashkimin Evropian, duke e rritur edhe eksportin e prodhimeve kosovare në tregun e Bashkimit Evropian.

Të gjitha këto do ta bëjnë Kosovën më të zhvilluar dhe më të gatshme për t'iu bashkuar familjes evropiane.

Më lejoni shkurtimisht t'i adresoj disa çështje që kanë zënë vend të madh në diskutimet publike që e përcojnë nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

U dhanë shumë mendime nëse është apo jo kjo marrëveshje si ato të rajonit? Një përgjigje e shkurtër në këtë drejtim: Në çdo aspekt, kjo marrëveshje është e ngjashme me marrëveshjet që kanë nënshkruar shtetet tjera të rajonit.

Por, është fakt i pamohueshëm që ne kemi një rast specifik me raport me Bashkimin Evropian dhe Bashkimi Evropian i sotëm nuk është Bashkimi Evropian që ka qenë para pesë, dhjetë apo 15 vjetësh.

Sa i përket pozicionit të Bashkimit Evropian në raport me ne, të gjithë janë të vetëdijshëm që pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës, por këto vende, me pajtimin e tyre për miratimin e kësaj marrëveshjeje, kanë treguar konstruktivitet. Pra, kanë pranuar që pavarësisht qëndrimet e tyre momentale, të mos i mohohet e drejta shtetit tonë që të ecën përpara drejt rrugëtimit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Andaj, besoj se kjo është diçka që ne duhet ta çojmë të gjithë.

Kjo marrëveshje është edhe një garanci shtesë për këto vende për orientimin tonë dhe sigurisht se do të shërbejë si një hap tjetër bindës për këto shtete që në një moment të caktuar edhe ato ta njohin Republikën e Kosovës.

Ndërsa sa i përket Bashkimit Evropian, korniza e tij ligjore, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, ka ndryshuar, andaj tani Bashkimi Evropian ka fuqi të lidhë marrëveshjet e stabilizim-asociim it në emër të shteteve, gjë që ka rezultuar me një proces të përshpejtuar në krahasim me atë nëpër të cilën kanë kaluar shtetet fqinje.

Tjetër, së fundi, u fol edhe për obligimet e kësaj marrëveshjeje që kanë të bëjnë me dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.

Ju e dini se Bashkimi Evropian i sheh zhvillimet e marrëdhëniet e mira fqinjësore ndërmjet vendeve që aspirojnë për anëtarësim në të si diçka thelbësore.

Kosova gjithnjë e ka promovuar fqinjësinë e mirë në kuadër të politikës së jashtme, e kjo ka qenë pa dyshim njëra nga arsyet që i ka bindur partnerët tanë se Kosova është e gatshme për ta filluar rrugëtimin formal të integritit nëpërmjet Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Obligimet që dalin nga kjo marrëveshje janë në plotëni me pajtimin, me qëllimet tona për shtrirjen e ligjit të Republikës së Kosovës përgjatë gjithë territorit dhe integritin e të gjithë qytetarëve me kornizën institucionale të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit që e kemi para vetes është rezultat i një procesi të mirëfilltë dhe një negociimi të kujdesshëm nga të gjitha institucionet relevante.

Me qëllim të koordinimit të procesit negociator, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 27 shkurt 2013 i themeloi strukturat negociuese për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, pra ekipin negociator dhe grupet punuese negociatore.

Negociatat kanë filluar më 28 tetor 2013 dhe përgjatë gjashtë muajve negociatash janë mbajtur tri takime në nivel të kryenegociatorëve dhe dhjetëra takime në nivel të grupeve punuese.

Negociatat përfunduan më 2 maj 2014, ndërsa më 25 korrik 2014 u vendosën inicialet fillestare në dokumentin e negociuar.

Më 22 tetor 2015, Këshilli i Bashkimit Evropian e miratoi MSA-në dhe më 27 tetor 2015 ajo u nënshkrua. Periudha e zbatimit të MSA-së është 10-vjeçare, ndërsa rishikimin do të mund ta bëjmë pas pesë vjetësh.

MSA-ja i ka gjithsej 597 faqe të ndara në 10 tituj, shtatë anekse, pesë protokolle dhe një deklaratë.

MSA-ja përmban katër pjesë kryesore: çështjet politike, përafrimi i legjislacionit, politikat e bashkëpunimit dhe çështjet tregtare.

Në vazhdim, më lejoni që shkurt t'i përmbledh disa nga këto çështje që i përmenda.

Nga këndvështrimi politik, MSA-ja i ka avancuar marrëdhëniet tona me Bashkimin Evropian, nga një marrëdhënie deklarative politike dhe e vullnetit të mirë në një marrëdhënie kontraktuale me të drejta dhe obligime për të dyja palët nënshkruese.

Si e tillë, MSA-ja është bazament i procesit formal të anëtarësimit tonë në Bashkimin Evropian.

Me nënshkrimin e MSA-së, Kosova e ka filluar rrugëtimin zyrtar drejt anëtarësimit në BE. Në kuadër të MSA-së, BE-ja merr obligim ta realizojë perspektivën evropiane të Kosovës, duke e integruar Kosovën me Bashkimin Evropian në harmoni me kriteret e Kopenhagës, të vitit 1993.

Nga këndvështrimi ligjor, MSA-ja ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka bazë të njëjtte ligjore sikur MSA-ja e të gjitha vendeve të rajonit.

MSA-ja është negociuar në bazë të nenit 218 të traktatit të funksionimit të Bashkimit Evropian.

Kjo bazë ligjore përcakton që Bashkimi Evropian mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare me shtete të treta.

MSA-ja e formalizon dialogun tonë institucional me Bashkimin Evropian nëpërmjet krijimit të mekanizmave institucionalë.

Republika e Kosovës ka marrë përsipër ta përafrojë legjislacionin ekzistues dhe legjislacionin e ardhshëm në mënyrë graduale me tërë legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në fazën e parë, rëndësi do t'i japim përafrimit të legjislacionit bazë të Bashkimit Evropian në fushat e tregut të brendshëm, aspektet tregtare dhe natyrisht edhe në fushën e sundimit të ligjit.

Nga këndvështrimi ekonomik, MSA-ja do të ketë një varg të efekteve pozitive.

Fillimisht duhet nënvizuar se MSA-ja synon krijimin e zonës së tregtisë së lirë ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian brenda 10 vjetëve, sa do të zgjasë zbatimi i saj.

Nga hyrja në fuqi e MSA-së do të mundësohen, në njërën anë, qasja e plotë e produkteve të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe, në anën tjetër, liberalizimi gradual, po specifikoj - liberalizimi gradual i tregut të Kosovës për produktet e Bashkimit Evropian.

Liberalizimi i tregut ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë tonë, që do të ofrojë shërbime më kualitative, produkte më të mira dhe çmime më të lira për qytetarët tanë.

MSA-ja do të afrojë më shumë stabilitet dhe parashikueshmëri për investitorët dhe rrjedhimisht do të kontribuojë edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte në Kosovë.

Në tërësi, MSA-ja do të ndikojë në ristrukturimin e ekonomisë sonë, rritjen ekonomike dhe në zvogëlimin e papunësinë.

Të nderuar deputetë,

Sot para nesh, para jush, e kemi një marrëveshje ndërkombëtare, e cila përfaqëson një ofertë të shkëlqyeshme politike, juridike dhe ekonomike për vendin tonë për t'iu bashkuar bllokut më të fuqishëm politik dhe ekonomik në botë.

Kjo marrëveshje është në interes të secilit qytetar të Republikës së Kosovës.

Dua ta falënderoj Komisionin Evropian dhe të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat kanë mbështetur dhe investuar shumë që sot ta kemi para nesh Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Unë vlerësoj se ratifikimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është ngjarja më e rëndësishme që ka ndodhur në Kuvendin e Republikës së Kosovës që nga shpallja e pavarësisë sonë.

Kjo ngjarje nuk është një dhuratë nga Bashkimi Evropian, por vlerësim real mbi të arriturat tona si vend dhe shoqëri.

Momenti i sotëm është meritë e ndërtuar mbi sakrificën e gjeneratave të kaluara dhe shpresës për gjeneratat e ardhshme.

Unë, duke e falënderuar gjithsecilin nga ju për gjithë punën që keni bërë edhe në të kaluarën, sepse ky proces ka filluar shumë vite më parë, ju falënderoj edhe sot të gjithë këtu që jeni të pranishëm për këtë mbështetje që po i jepni ratifikimit të kësaj marrëveshjeje. Mesazhi juaj është mesazhi i domosdoshëm për të cilin qytetarët e Republikës së Kosovës sot kanë nevojë më shumë se asnjëherë më parë.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto që i thashë më lart, ju ftoj që njëzëri ta miratojmë këtë marrëveshje kaq të rëndësishme për Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Tani e ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional për Integritet Evropian, zonjën Teuta Sahatqija, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

TEUTA SAHATQIJA: E nderuar Presidente,

I nderuar kryeministër, Qeveri,

I nderuar kryetar i Kuvendit, Veseli,

Shumë të respektuar kolegë deputetë,

Komisioni për Integritet Evropian e mbajti mbledhjen dhe në bazë të nenit 60, paragrafi 3, si dhe 69, paragrafi 5, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2015, e shqyrtoi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim: Të miratohet Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

Komisioni për Integritet Evropian e propozoi amendamentin, që është votuar në mënyrë unanime. Amendamenti 1 thotë: Në titullin e Projektligjit, para fjalës “Kosovë” të shtohet fjala “Republikë” dhe ky ndryshim të vlejë në tërë tekstin. Duke pasur parasysh që ky projektligj është ligj i Kosovës, ka të bëjë me legjislacionin e Kosovës dhe miratohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, mendoj që ky amendament është i domosdoshëm dhe nuk e prek dokumentin e MSA-së, dokumentin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim dhe si i tillë mendojmë që duhet të votohet së pari amendamenti, e pastaj të votohet edhe projektligji, në përgjithësi.

Kam nderin që para jush në këtë seancë ta paraqes arsyetimin dhe rekomandimin për ratifikimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian për Energji Atomike, në anën tjetër.

Sot në këtë seancë është një ditë e rëndësishme, ku për herë të parë me ratifikimin e marrëveshjes së MSA-së vendosim marrëdhëniet kontraktuale me Bashkimin Evropian. Vendosja e marrëdhënieve kontraktuale nënkupton njëherësh edhe fillimin zyrtar të rrugëtimit të Kosovës, të Republikës së Kosovës drejt anëtarësimit në BE.

Të gjitha vendet që e kanë nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit e kanë një perspektivë të qartë evropiane dhe kjo njëjtë garantohet edhe për Kosovën në mënyrë të shprehur në MSA-në, ashtu siç e shpjegoi edhe ministri Çollaku nga Qeveria.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju ftoj që ta votoni amendamentin, që ta votoni projektligjin dhe me votimin tonë në mënyrë unanime të bëjmë që MSA-ja të ratifikohet dhe ta fillojë implementimin, prej së cilës, në rend të parë, do të përfitojnë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe pastaj edhe shteti i Kosovës në arenën ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Sahatqija! Tani është radha e kryetarëve, ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Përshëndetje, zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

E nderuar Presidente,

Kolegë të nderuar deputetë,

Republika e Kosovës është vendi i fundit nga Ballkani Perëndimor që nuk e kishte të nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila është parakusht për integritet afatgjatë drejt Bashkimit Evropian. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Kosova vendos marrëdhënie kontraktuale dhe hap qasje dhe mundësi të mira në tregun e madh evropian. Edhe pse sot është fillimi për një marrëdhënie të shëndoshë, e cila do të ketë plot sfida në rrugëtimin e saj, vullneti politik evropian dhe gatishmëria e kosovarëve për të arritur marrëdhënie kontraktuale do ta bëjë të suksesshëm këtë fillim.

Fillimet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit i kemi që nga viti 2012, ndërsa kjo ishte e mundur të bëhet vetëm pas fillimit të bisedimeve dhe marrëveshjes së vitit 2013. Këshilli i Bashkimit Evropian, më 11 dhjetor 2012 ka konfirmuar që Kosova do t'i fillojë negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, pasi kriteret për hapjen e negociatave janë përmbushur dhe ja ku jemi sot këtu për të bërë votimin më të shumëpritur si proces që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Të mos harrojmë se marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës në vitin 2013 e kishte për qëllim edhe këtë ditë, e sot me të drejtë i gëzohemi të gjithë. Pjesë e asaj marrëveshje ishte edhe një marrëveshje që të dyja vendet nuk do ta bllokojnë perspektivën e tyre individuale të integritimit në Bashkimin Evropian. Nuk duhet harruar fakti se Komisioni Evropian propozoi që Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës do të nënshkruhet nga BE-ja si një njësi e vetme, në vend që të ratifikohet nga të gjitha shtetet anëtare.

Qëllimi ishte rruga jo sfiduese procedurale për shtetet që nuk e kanë njohur Kosovën dhe kjo procedurë u miratua nga Këshilli i Bashkimit Evropian, nga të gjitha 28 vendet e saj anëtare.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar miq ndërkombëtarë,

Një Kosovë e izoluar do të thotë një vrimë e zezë në Ballkanin Perëndimor dhe, rrjedhimisht, kjo kishte për rrezik t'i ngadalësojë proceset integruuese të kësaj pjese të Ballkanit Perëndimor, por me ndihmën tuaj sot erdhi dita kur Kosova përfundimisht vihet në binarët të rrugëtimit evropian dhe me liberalizimin e vizave, meqë së shpejti presim vlerësim pozitiv, vrima e zezë do të mbetet vrimë historike, e cila do t'i takojë së kaluarës dhe do të jetë një mësim për vështirësitë e rrugëtimit të shtetndërtimit dhe integritimit në familjen e madhe evropiane.

Shpresojmë se forca e BE-së dhe vullneti i saj politik do të shërbejë ngjashëm karshi Kosovës sikur për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, edhe me liberalizimin e vizave. Pragmatizmi evropian besojmë shumë se do të vihet në funksion edhe për këtë çështje.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, ju bëj thirrje të gjithëve që sot ta bashkojmë votën tonë dhe ta miratojmë, t'i japim mbështetje kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zotin Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar presidente Jahjaga,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar përfaqësues të misionëve diplomatike,

Të nderuara dhe të respektuar kolegë deputetë,

Dita e sotme, seanca e sotme është pa dyshim ndër ditët më të veçanta për Kuvendin e Kosovës, për qytetarët e Kosovës, për Republikën e Kosovës, është edhe një ditë solemne. Marrëveshja e

Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian pa dyshim paraqet ngjarjen më të rëndësishme që nga shpallja e pavarësisë sonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi të vetëdijshëm që e dimë rëndësinë e kësaj marrëveshjeje për të ardhmen e qytetarëve tanë, të ardhmen e vendit tonë, por shkurtimisht do t'i them disa fjalë për rëndësinë që ka për Republikën e Kosovës nënshkrimi i MSA-së me Bashkimin Evropian. Procesi i stabilizim-asociimit, i iniciuar që në vitin '99 dhe i rikonfirmuar në Samitin e Selanikut më 2003, është politikë e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor, me qëllim të hapjes së dyerve për anëtarësim. Kjo nënkupton arritjen e stabilitetit në rajon dhe krijimin e një tregu të lirë dhe ekonomive të afta që të konkurrojnë në tregjet evropiane.

Elementet e procesit të stabilizim-asociimit sigurisht që bazohen në relacionet kontraktuale, relacionet tregtare, asistencë financiare, bashkëpunim rajonal dhe relacionet e mira fqinjësore. Perspektivat e integritit evropian janë treguar shtytësi thelbësor për reforma për vendet që tanimë janë anëtarësuar dhe vendet që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Republika e Kosovës e ka të konfirmuar dhe të palëkundur konsensusin shoqëror dhe politik drejt integritit në familjen e madhe evropiane.

Duke u zotuar në përmbushjen e reformave të nevojshme për anëtarësim, rrjedhimisht Republika e Kosovës e ka nënshkruar MSA-në me Bashkimin Evropian duke hyrë në relacione kontraktuale si rezultat i reformave të deritanishme dhe për t'u zotuar për reforma të mëtejshme politike, ekonomike, tregtare, në sferën e të drejtave të njeriut, të sundimit të ligjit e tjera.

Në anën tjetër, Republika e Kosovës do të ketë qasje të lehtësuara në tregjet e BE-së, asistencë financiare dhe teknike që do të na ndihmojë për ta rritur performansën e funksionimit tonë institucional dhe të ekonomisë, në përgjithësi. Asistenca financiare në kuadër të IPA-së për Kosovën për periudhën 2014-2020 arrin shumën 645,5 milionë euro. Financimi do të kontribuojë në këta sektorë, ose në disa sektorë prioritarë, si ai të zhvillimit demokratik dhe të qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore, në sektorin e energjisë, të qenët konkurrent dhe inovativ, në ekonomi, arsim, punësim dhe politika sociale, bujqësi dhe zhvillim rural.

Bizneset kosovare do të kenë qasje në një treg prej 500 milionë konsumatorësh në 28 shtete anëtare të BE-së. Produktet e BE-së do të ofrohen me çmime më të lira për qytetarin, liberalizimi i tregut me BE-në do t'i identifikojë përparësitë krahasuese të ekonomisë sonë dhe do ta rrisë eksportin. MSA-ja do të ketë ndikim pozitiv edhe në rritjen e investimeve të huaja direkte. MSA-ja po ashtu e formalizon dialogun politik ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe krijon mekanizma institucionale për zbatimin e MSA-së, siç janë: Këshilli i Stabilizim-Asociimit, Komiteti i Stabilizim-Asociimit, nënkomitetet e stabilizim-asociimit dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asociimit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me miratimin e MSA-së, mundëson që Kosova të hyjë në periudhën 10-vjeçare të implementimit, që i nënshtrohet një procesi të rishikimit pas pesë vjetësh. Mbetet shumë punë për t'u bërë në arritjen e synimit tonë për anëtarësim në BE, me angazhimin e të gjithë neve në përmbushjen me përgjegjësi të obligimeve që dalin nga

marrëveshjet me partnerët tanë, pos aspiratës do të tregojmë edhe sjellje të qytetëruar dhe evropiane.

Të qenët anëtar i Bashkimit Evropian do të thotë të sillemi edhe si të tillë, si evropianë. Kjo nënkupton po ashtu se krahas përfitimeve të theksuara politike dhe ekonomike, ne si shtet marrim edhe obligime të caktuara, të cilat duhet t'i kryejmë me përgjegjësinë më të lartë. Ne si shtet i ri duhet të sillemi me përgjegjësi dhe me seriozitetin më të madh karshi obligimeve që i marrim, me punën tonë ne duhet të dëshmojmë se e meritojmë të jemi pjesë e integruar e Evropës, pjesë e familjes evropiane, jo vetëm gjeografikisht, por edhe politikisht, edhe ekonomikisht, të jemi evropianë jo vetëm me fjalë, por edhe me punë, seriozitet dhe përgjegjshmëri.

Këtë e kemi obligim para qytetarëve tanë. Qytetarët e Republikës së Kosovës na obligojnë dhe na mbajnë përgjegjës që të vazhdojmë të punojnë drejt integritit tonë euroatlantik. Qytetarët tanë e kanë shprehur dhe kërkuar qartë që jemi jetësisht të interesuar dhe i vetmi vend ynë është familja e madhe evropiane, të qenët pjesë e saj me të drejta dhe obligime - pjesë në të ardhmen e Bashkimit Evropian dhe kuptohet ruajtja, vazhdimi dhe thellimi i mëtejme i miqësisë sonë të përhershme edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo marrëveshje konfirmon atë për çka jemi zotuar një kohë të gjatë, që nga koha e presidentit historik Ibrahim Rugova, se rruga integruese në struktura euroatlantike është rruga e drejtë dhe e vetme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është për ne gur themel i shtëpisë sonë, shtëpi kjo që po i bashkohet një shtëpie të madhe - familjes të quajtur Bashkimi Evropian. Të sillemi të përgjegjshëm, jo vetëm me fjalë, por edhe me punë në këtë mundësi dhe detyrë që na është dhënë. Jemi në prag të anëtarësimit në shumë mekanizma ndërkombëtarë, siç është UNESCO, pastaj na pret procesi i fillimit të liberalizimit të vizave dhe shumë procese të rëndësishme për vendin tonë.

Qytetarët tanë meritojnë të jemi në nivel të detyrës, meritojnë të qarkullojnë lirshëm nesër, meritojnë të mos i pengojë askush në këtë rrugëtim, e ky rrugëtim është i pandalshëm dhe i pakthyeshëm sepse përcaktimi ynë, i qytetarëve tanë, është i qartë - duam të jemi pjesë e familjes evropiane me të drejta dhe detyra.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah dhe do të votojë për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, për projektligjin që e kemi para vetes, duke besuar thellë se me këtë votim pro ne po e kryejmë një obligim edhe para qytetarëve tanë, të cilët mund të thuhet se sikur me plebishit kaheër janë përcaktuar për këtë rrugë, rrugën tonë evropiane dhe euroatlantike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zotin Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Natyrisht që kur një vend ka aspirata për t’u integruar në Bashkimin Evropian, nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit e paraqet një hap përpara drejt integriteteve evropiane dhe si i tillë në parim është për t’u përshëndetur.

Por, problemi i parë i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për Kosovën është se në çfarë statusi po e nënshkruan dhe e ratifikon Kosova këtë marrëveshje me Bashkimin Evropian? Kjo është çështja kryesore e MSA-së. MSA-ja me BE-në po ratifikohet duke e kategorizuar Kosovën si një entitet të kontestueshëm. Të kontestueshëm statusin e Kosovës natyrisht që e bën fusnota, e cila i është vendosur në këtë marrëveshje, e fusnota, siç e dimë, është një marrëveshje e cila është arritur me Serbinë në negociatat e Brukselit.

Fusnota, ashtu sikur ‘Zajednica’, ka qenë kërkesë e Serbisë dhe fusnota thotë që për Kosovën vlen edhe Rezoluta 1244, edhe mendimi apo opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e kjo i bie që Kosova është edhe autonomi e Serbisë dhe protektorat nën Administratën e OKB-së, por, në anën tjetër, që është edhe e pavarur. Pra, që njëra palë, Serbia, mendon që legjitime për Kosovën është Rezoluta 1244, kurse Kosova mendon që është shtet i pavarur.

Pra, fusnota e ka dëmtuar seriozisht procesin e shtetndërtimit të Kosovës, sepse ajo e vulos Kosovën si rajon të kontestueshëm, si një çështje të hapur dhe të pazgjidhur dhe kjo, tek e fundit, është synim i Serbisë. Dhe, tash Kosova po e miraton legjislacionin vendor, i cili e ka edhe fusnotën brenda. Po miraton legjislacion me termin “Kosovë” dhe me fusnotë, që është marrëveshje me Serbinë.

A po e shihni, pra, se si fusnota filloi si një ide për përfaqësim të Kosovës nëpër forume rajonale dhe tash dalëngadalë po fillon të bëhet edhe emri ynë i brendshëm, ajo qysh ne e quajmë vetveten.

Problemi i dytë i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është arsyeja bazike pse erdhi MSA-ja në Kosovë. MSA-ja nuk u kushtëzua nga Bashkimi Evropian me luftimin e korrupsionit. MSA-ja nuk erdhi pse pati reforma në sistemin e drejtësisë. MSA-ja nuk erdhi pse Qeveria e depolitizoi Administratën shtetërore. Përkundrazi, të gjitha raportet ndërkombëtare tregojnë se Kosova në këto tri fusha, fatkeqësisht, ka shënuar hapa mbrapa. MSA-ja erdhi veç për një arsye - për shkak të marrëveshjeve me Serbinë.

Por, marrëveshjet me Serbinë, secila prej tyre, nuk bazohet në reciprocitet ndërshtetëror, plus që marrëveshja për bashkësinë e komunave me shumicë serbe ia krijon Beogradit brenda Republikës sonë një instrument të fuqishëm, të cilin me siguri që Serbia në të ardhmen do ta përdorë kundër shtetit tonë.

Qytetarët do të kishin qenë shumë më të gëzuar dhe do t’ia kishin parë hairin MSA-së shumë më tepër nëse kjo do të kishte ardhur si pasojë e heqjes së korrupsionit, pavarësisë së Gjyqësorit, luftimit të krimit të organizuar, departizimit të Administratës Publike dhe vendosjes së

meritokracisë në punësime sa i përket sektorit publik. Por, ajo nuk po vjen për shkak të këtyre kushteve. Kushti i saj bazik është kuadri i marrëveshjeve me Serbinë.

Kjo është goxha problematike, sepse nënkupton që rruga e Kosovës për integritet evropian kalon nëpër Beograd. Nenet 5 dhe 13, pra këto dy nene, lexojini, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit për Kosovën thotë në mënyrë eksplicite se shkëputja e njëanshme e MSA-së nga BE-ja varet mbi të gjitha nga zbatimi, që Kosova do t'ua bëjë marrëveshjeve të Serbisë. Pra, ky është ai guri vendimtar i MSA-së për Kosovën.

Këtu sërish duhet ta sjellim ndërmend një asimetri më se të dukshme. Serbia, për shembull, nuk e ka në MSA-në e saj këtë kusht, që nëse nuk i zbaton marrëveshjet me Kosovën BE-ja ia shkëput në mënyrë të njëanshme këtë marrëveshje Kosovës. Bile, Gjykata Kushtetuese e Serbisë edhe e ka rrëzuar ndonjë marrëveshje që është arritur me Kosovën, por Bashkimi Evropian nuk ka reaguar për këtë. Nuk e ka pasur si kusht, që nëse ndonjë prej marrëveshjeve me Kosovën e hedh poshtë, atëherë do të rishqyrtohet marrëdhënia e Bashkimit Evropian me Serbinë. Ama Kosova i ka këto kushte. Dhe, kjo e bën raportin goxha të pabarabartë.

Ne, natyrisht, që jemi për integritet evropian. Edhe ne e shohim Republikën e Kosovës në Bashkimin Evropian. Këtu nuk kemi dyshime. Por, jemi fuqimisht kundër asaj që vlerësimi për ne se sa jemi të gatshëm për Bashkimin Evropian të reduktohet në nivelin e nënshtërimit të Kosovës ndaj Serbisë. Ndaj kësaj jemi kundër. Stabiliteti i rajonit, perspektiva evropiane e Kosovës dhe fqinjësia e mirë nuk janë të qëndrueshme dhe të sigurta nëse ndërtohen mbi raporte subordinuese, siç po ndodh ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Krejt në fund, Marrëveshja për Stabilizim-Asociim është një pako kushtesh, siç e dimë të gjithë, të cilat nëse nuk plotësohen atëherë nuk ka integritet evropian. Nëse në një shtet ka qeveri të korruptuar, nëse kjo qeveri është e paaftë dhe e pavullnetshme për t'i luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, nëse Qeveria e kontrollon drejtësinë dhe nëse Qeveria i ka kapur institucionet e pavarura shtetërore, atëherë procesi prej MSA-së deri te anëtarësimi ngrihet plotësisht.

Rastin e kemi këtu afër. Ja shiheni Maqedoninë, për shembull. Maqedonia e ka ratifikuar MSA-në në vitin 2001, para 14 vjetësh. Por, anëtarësimi në BE duket ende shumë larg me Qeverinë e Nikola Gruevskit, e cila më së shumti i përngjan kësaj Qeverisë sonë. Përveç kësaj, Qeveria e Kosovës me marrëveshjet e fundit me Serbinë e ka dëmtuar seriozisht perspektivën evropiane të Kosovës.

Ju e dini që shtetet që ndodhen krejt në fund të proceseve të integriteteve evropiane janë dy. Krejt në bisht të integriteteve evropiane janë Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova. Këto dy shtete madje nuk kategorizohen as si kandidatë. Statusi i tyre është “kandidatë potencialë”. Kjo i bie që janë në pritje për t'u bërë kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Pra, në anën tjetër, ka pasur një sërë zyrtarësh të Bashkimit Evropian që kanë thënë se Bosnja e ka shumë problem për t'u anëtarësuar, për t'u bërë anëtare kandidate me të drejta të plota edhe anëtare e plotë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, për arsye të funksionimit të saj të brendshëm, për shkak të organizimit të saj institucional shtetëror. Aq janë të ndërlikuara aty nivelet e pushtetit dhe aq ka

kundërthënie ndërmjet Republikës Serbe dhe Federatës Kroato-Boshnjake, sa një shtet i tillë as nuk mund të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian.

Tash, Qeveria e Kosovës me marrëveshjen e 25 gushtit, në Bruksel, faktikisht e ka futur Kosovën në një proces të bosnjëzimit, kur Kosova do të përbëhet prej dy niveleve të pushtetit, do të funksionojë prej dy pjesëve. Autoriteti i institucioneve qendrore, i Qeverisë dhe i ministrive me departamente, e me institucione tjera, dhe autoriteti i 'Zajednicës', që një pjesë e territorit të Kosovës do ta ketë të drejtën për t'i marrë disa vendime të caktuara, të cilat nuk e ka të drejtën për t'i shqyrtuar Qeveria e Kosovës. Kjo është uverturë për bosnjëzimin e Kosovës. E atëherë, unë vetëm po e shtroj një pyetje për juve, nëse pas dhjetë vjetësh këtu në Parlamentin e Kosovës, atëherë kur mund të afrohet koha për të biseduar ne për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian, vjen këtu një zyrtar i BE-së dhe na thotë: "Na falni, por para dhjetë vjetësh keni marrë disa vendime, të cilat e kanë komplikuar këtë sistemin e pushtetit në Kosovë aq shumë ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, sa që ju nuk mund të ju bëjmë pjesë të Bashkimit Evropian". Atëherë, a më tregoni, kush prej jush jep llogari për këtë vend?

Kush prej jush jep përgjegjësi se çfarë ndodhi? Mendoj se në këtë rast kjo është pyetja kryesore që duhet shtruar.

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zonjën Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Të nderuar të pranishëm,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ishte, është dhe do të jetë në vazhdimësi e përkushtuar dhe e angazhuar për Kosovën në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe këtë e kemi dëshmuar në të kaluarën, do ta dëshmojmë në të ardhmen dhe do ta dëshmojmë edhe sot.

Angazhimi i Kosovës dhe qytetarëve të saj në rrugën proevropiane është përkushtim i brezave dhe si i tillë është përkrahur fuqishëm dhe vazhdueshëm nga Aleanca. Sot kemi ardhur për ta konfirmuar këtë rrugëtim, për ta dëshmuar që ne i përkrahim këto procese, të cilat në rast të një qeverie të mirëfilltë do të sillnim përfitime të mëdha për Kosovën.

Të nderuar të pranishëm,
Kjo rrugë properëndimore dhe proceset e integritimeve janë lënduar rëndë sot nga njerëz të cilët janë ulur prapa dhe njerëz, të cilët bartin përgjegjësi kryesore në këtë Qeveri, sepse të njëjtit janë peng i veprimeve të tyre korruptive, të cilat shkojnë në parimet themelore të kësaj marrëveshjeje dhe nëse i lexoni do të shihni. Forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës janë dy parimet themelore të kësaj marrëveshjeje. Kjo qeveri, me të gjitha veprimet e saj të deritanishme dhe në të kaluarën, ka vepruar pikërisht në kundërshtim me to.

Prandaj, duke qenë se e kemi këtë Qeveri politikisht të shantazhuar, udhëheqës të cilëve dosjet u qëndrojnë mbi kokë, substanca e kësaj marrëveshjeje ka shumë defekte, është shumë e brishtë dhe shumë e pamjaftueshme. Pasi negociatorët kanë pozicion të dobët karshi Bashkimit Evropian, si pasojë e dështimeve të mëdha dhe përfshirjes edhe personale, edhe partiake në krim,

në korrupsion, në moszbatim të ligjeve dhe shpërfillje të tyre, sot, në vend se të negociojnë për interesat e vendit, ata negocian për ndonjë amnisti personale.

Prandaj, lëshimet më të mëdha në dokumentin e MSA-së janë edhe të natyrës politike, por edhe të natyrës ekonomike, duke filluar nga fusnota, e cila e legjitimon statusin neutral të Kosovës dhe nuk ishte “fluskë bore”, siç u pretendua këtu, nuk u shkri asnjëherë, por përkundrazi po forcohet dita-ditës dhe po bëhet pengesë e trajtimit adekuat të njohjes së Kosovës shtet, madje po bëhet mekanizëm për ta mohuar shtetësinë e Kosovës, e deri te mosnegocimi për kuota, që janë në interes të qytetarëve, e sidomos të bizneseve dhe të prodhuesve, që janë në interes të gjithë territorit të Kosovës.

Megjithëkëtë, të nderuar kolegë, ne sot, siç po e shihni, jemi këtu. Jemi këtu të përkushtuar që ta përkrahim ecjen e Kosovës drejt Bashkimit Evropian dhe Euroatlantik, mirëpo janë qeveritarët ata të cilët në vazhdimësi po e bllokojnë këtë ecje. E kanë bllokuar me krim, me korrupsion. Kosovën e kanë lënë të izoluar si pikën më të zezë në Ballkan dhe po vazhdojnë ta bllokojnë. Po vazhdojnë ta bllokojnë nëpërmjet dy marrëveshjeve të dëmshme, tepër të dëmshme, Asociacionit dhe demarkacionit. Po vazhdojnë ta bllokojnë Kosovën në momentin kur nuk e kanë përkrahjen e qytetarëve, sepse vetëm 15% e qytetarëve janë të kënaqur me punën e tyre dhe pikërisht në këtë kohë po i nënshkruajnë këto marrëveshje dhe po provojnë ta bllokojnë zërin e arsyes, po provojnë që të mos lejojnë 200 mijë nënshkrime të qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilat janë kundër këtyre dy marrëveshjeve, që të futen në Kuvend. Dhe, kjo nuk është as me parimet e demokracisë dhe as me parimet e Bashkimit Evropian.

Ju dje provuat që t’i ndalni deputetët që të përcjellin zërin e 200 mijë qytetarëve kundër dy marrëveshjeve të dëmshme, ndërkaq sot po thirrni për unitet dhe kërkonin madje votën e opozitës. Nëse rastësisht keni dështuar me partnerët e koalicionit dhe nuk e keni këtë votë, ne jemi këtu për të reflektuar në të mirën e vendit dhe të interesave të Kosovës, por paraprakisht ju duhet të reflektoni, t’i tërhiqni nënshkrimet nga dy marrëveshjet e dëmshme, të cilat do ta bllokojnë në vazhdimësi Kosovën. Dhe, kjo bllokadë nuk do të jetë, për fatin e keq të Kosovës, vetëm në mandatin tuaj, sepse mostërheqja e këtyre dy nënshkrimeve do të vazhdojë për breza e për gjenerata dhe do të jetë peng mbi supet e brishta të Kosovës për vitet e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tash e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Listës serbe, zotërinë Slavko Simiq, që ta marrë fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovana predsednice,

Poštovani predsedniče Vlade,

Poštovani potpredsednici,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Poslanička grupa Srpske liste daje punu podršku potpisivanju Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju Kosova i Evropske unije.

Sporazum o stabilizaciji i pridruživanju predstavlja veoma bitan korak za Kosovo, a takođe i za čitav region u našem pokušaju da stvorimo potpuno otvoreno tržište gde će privatni sektor igrati ključnu ulogu u ekonomskom razvoju, jer će sporazum omogućiti čvrste ekonomske i trgovinske veze Evropske unije i Kosova.

U isto vreme, Sporazum o stabilizaciji i pridruživanju znači i dodatnu obavezu za sve kosovske institucije kojima je potrebna reforma i Srpska lista će nastaviti da podržava koalicionu vladu u njenom naporu da kreira zakone, koji će još više pomoći ekonomskom i demokratskom razvoju Kosova.

U tom smislu, Sporazum o stabilizaciji i pridruživanju otvara još više mogućnosti za preduzetnike na Kosovu i kao takav, Sporazum treba biti podržan i od strane svih građana Kosova, od strane svih zajednica koje žive na Kosovu i danas ovde u Parlamentu treba biti podržan od strane svih poslaničkih grupa. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar “Nisma”, zonjën Valdete Bajrami, ta marrë fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Unë sot nuk do ta zgjas shumë fjalën time, por dua t’i them disa fjalë shumë të shkurtra.

Vërejtjet tona si Grup Parlamentar “Nisma për Kosovën” në lidhje me Marrëveshjen e MSA-së i kemi, duke u nisur nga neni 1 deri në nenin 13, mirëpo nga këtu dua të bëj të qartë se “Nisma për Kosovën” ka qenë dhe do të jetë gjithnjë pro rrugës së BE-së dhe gjithnjë drejt bashkimit familjar evropian, pasi edhe si popull paqedashës nuk e meritojmë të mbetemi jashtë BE-së.

“Nisma” do të angazhohet gjithnjë t’i ruajë raportet me instrumentet ndërkombëtare, me organizatat ndërkombëtare të cilat kontribuojnë dhe të cilat kanë kontribuar në proceset që na presin drejt rrugës së BE-së dhe si obligim shtetëror.

Mirëpo, “Nisma” gjithnjë është kundër marrëveshjeve, të cilat bëhen në dëm të vendit, marrëveshjeve të cilat e cenojnë sovranitetin e vendit.

Përcaktimi i popullit tonë është drejt rrugës së BE-së dhe jemi pro rrugës së BE-së, e gjithashtu “Nisma” do të angazhohet dhe do të punojë në realizimin e kërkesave të qytetarëve, pasi pikërisht qytetarët janë ata të cilët e mbështetin dhe përkrahin rrugën drejt BE-së.

Gjithashtu, nga këtu bëj edhe një herë apel dhe kërkesë që “Nisma” mbështet çdo veprim dhe çdo rrugëtim i cili është në të mirën e qytetarëve dhe në të mirën e vendit, por assesi jo për vendimet të cilat merren në dëm të qytetarëve dhe në dëm të sovranitetit të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar “6+”, zotin Kujtim Paçaku, ta marrë fjalën.

KUJTIM PAÇAKU: I nderuar kryetar i Parlamentit,

E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Jahjaga,
I nderur kryeministër,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar kor diplomatik,
Të nderuara media,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Grupi Parlamentar “6+”, në përbërje të komuniteteve rom, turk, boshjak e ashkali, i jep përkrahje Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ne jemi të vetëdijshëm se me këtë nënshkrim hapen rrugë për integritet evropian, në Bashkësinë Evropiane dhe shkojmë më afër liberalizimit të vizave.

Jemi të sigurt se me këtë nënshkrim do të zbutet edhe papunësia, do të kemi ekonomi më cilësore dhe arsim e punësim për të gjitha komunitetet.

Me këtë nënshkrim jemi të sigurt se do të rriten edhe më tepër marrëdhëniet bilaterale me tregun evropian, e po ashtu do të kemi edhe investime kapitale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit konfirmon një integritet në Kosovë në BE dhe integritet euroatlantike, pjesë përbërëse e të cilave do të jetë së shpejti Kosova në kontinent më të vjetër të botës.

Faleminderit dhe konfirmoj se Grupi Parlamentar “6+” është pro kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani e kemi të paraqitur deputetin Ilir Deda, i cili kësaj radhe është diskutues nga deputetët e Kuvendit të Kosovës. Urdhëroni, zoti Deda!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Unë sot e përfaqësoj një pjesë të opozitës, e cila është kundër Qeverisë së Kosovës, por nuk është kundër MSA-së. Dhe, ka shumë qytetarë në Kosovë, të cilët nuk janë me Qeverinë PDK-LDK, por janë për MSA-në.

E nderuar presidente,
Ju kujtohet që ky proces e ka një fillim dhe fillimi i MSA-së ka qenë në vitin 2011. Ne askush nuk na e ka dhënë MSA-në, sepse ne vetë e kemi kërkuar Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim dhe gjatë vitit 2011 argumenti, në atë kohë kur Kosova ka qenë e izoluar, në atë kohë kur Kosova ka pasur institucione jokredibile për shkak të procesit jodemokratik zgjedhor të dhjetorit 2010, në atë kohë kur dukej që ne me të vërtetë do të bëhemi vrimë e zezë, e cila do të futet në kaos të brendshëm, thoshim se e vetmja mënyrë për avancimin e procesit të reformave të Kosovë janë marrëdhëniet kontraktuale të Bashkimit Evropian dhe të Kosovës dhe atëherë u vendos në tavolinë zyrtarisht kërkesa e Republikës së Kosovës që ta ketë procesin e MSA-së me Bashkimin Evropian.

Sot duhet të falënderohen edhe njerëzit, të cilët ishin nismëtarë të kësaj, e posaçërisht zonja Venera Hajrullahu, zoti Qëndrim Gashi, zonja Ariana Qosaj Mustafa, zoti Arbër Vllahu, zoti Ilir Salihu, zoti Ramush Tahiri, e më pastaj zonja Vlora Çitaku, Bekim Çollaku, Mimoza Kusari.

Presidente, edhe ju me ngulm keni insistuar që të ketë marrëdhënie kontraktuale ndërmjet Kosovës e BE-së dhe ne sot kemi mbërri te pika e ratifikimit të MSA-së në Kuvendin e Kosovës.

Nëse e shikojmë këtë rrugëtimin shtetëror në 7 vjetët e fundit, janë 3 momente kyçe. E para është shpallja e pavarësisë, e dyta ka të bëjë me mendimin këshillëdhënës të GJND-së dhe e treta është kontraktualiteti i marrëdhënieve Kosovë - BE.

MSA-ja nuk është integrim në Bashkimin Evropian dhe nuk bën që ta keqkuptojmë si të tillë. MSA-ja është asociim ekonomik i Kosovës me Bashkimin Evropian. MSA-ja vendos rregullat e funksionimit demokratik dhe kontratë ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Kjo MSA nuk është 100% e njëjtë me atë që e kanë shtetet tjera në Ballkan. Po kjo MSA, në të njëjtën kohë, është shumë më e mirë se sa draftet që i janë ofruar Kosovës më herët. Dhe, në realitetin e bllokimit të BE-së karshi statusit të Kosovës, kjo MSA është mundësi për zhvillim.

Marrëveshja për Stabilizim-Asociim është mundësi për zhvillimin e ekonomisë sonë, për rritjen e konkurrueshmërisë dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj. Është mundësi, s'do të thotë që do të ndodhë, por është mundësi!

Marrëveshja e MSA-së është mundësi që dialogun me Serbinë ta kthejmë në fitore. Qysh? Duke i respektuar kriteret e Kopenhagës, që do të thotë marrëdhënie të mira ndërfqinjësore me të cilat ne sot, nëse ratifikohet marrëveshja, bëhemi me të drejtë ndërkombëtare të obliguar që ta zbatojmë dhe që marrëveshjet me Serbinë të jenë në përputhje me 'acquis communautaire'.

'Acquis communautaire' nuk njeh diskriminim të brendshëm, në legjislacion. Dhe me këtë ne mund t'i kthejmë edhe marrëveshjet e dëmshme në fitore. Unë personalisht nuk besoj se kjo Qeveri do të jetë në gjendje që ta bëjë këtë kthesë. Por, Kosova ka mundësi edhe në të ardhmen ta bëjë kthesën e tillë.

Dhe, një gjë e cila nuk ka qenë në draftet e mëhershme të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim ka qenë premtimi dhe përkushtimi i Bashkimit Evropian që ta integrojë Kosovën në botën demokratike, si e quajnë ata, në një pjesë të bashkësisë ndërkombëtare, ku edhe 5-shja, e cila nuk na ka njohur, tash nuk do ta bllokojë, sepse MSA-ja e cila ratifikohet këtu dhe që do të ratifikohet në Parlamentin Evropian do të bëhet e obligueshme edhe për shtetet tjera.

Tash kjo MSA nuk na e garanton neve statusin e kandidatit. Dhe, duhet të jemi të sigurtë, nuk i garanton, por e jep mundësinë që në qoftë se fokusohemi në reforma të mirëfillta, ato edhe t'i bëjmë. Na e jep mundësinë që në një të ardhme ne të jemi gati, si për statusin e kandidatit, edhe për më tepër, por kjo varet prej përkushtimit institucional.

Dhe, çka është njëjtë, shumë me rëndësi, të mos harrojmë, unë nuk pajtohem që kjo MSA e konsideron Kosovën edhe si pjesë të Serbisë, e Serbia MSA-në e tyre në vitin 2007 e ka të nënshkruar pa territorin e Kosovës, kështu që kjo MSA është për Republikën e Kosovës. Dhe, me ligj ndërkombëtar, me të drejtën ndërkombëtare, ratifikimin e sotëm, me propozim të përbashkët - të Komisionit për Integritet Evropian, ne para botës do të paraqitemi si shtet.

Po! Në tekst shkruan BE-ja nuk e njeh Kosovën, por ne e njohim vetveten. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Zoti kryetar,

Zonja presidente,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Arsyeja pse e mora fjalën është sepse mendoj se ne që kemi shërbyer dhe vazhdojmë të shërbejmë në Komisionin për Integritet Evropian dhe për vite të tëra së bashku me Qeverinë e Kosovës, Qeverinë e kaluar dhe me Qeverinë e tanishme kemi punuar bashkë, kemi qenë një ndër shembujt më të mirë në Republikën e Kosovës sesi ndërtohet uniteti politik për çështje të rëndësishme nacionale, siç është perspektiva euroatlantike e Kosovës.

Kjo u dëshmuar edhe sot, kur amendamenti i propozuar nga zoti Deda në Komisionin për Integritet u votua unanimisht. Pra, u votua edhe nga përfaqësuesit e LDK-së dhe të PDK-së, edhe nga përfaqësuesit e opozitës që ishin të pranishëm, por u votua edhe nga përfaqësuesit e komuniteteve pakicë. Dhe, kjo më bën të ndihem shumë mirë për një punë jashtëzakonisht të rëndësishme, në të cilën kanë kontribuar shumë njerëz, shumë nga të cilët i përmendi edhe Iliri pak më herët, dhe që ka dëshmuar se ratifikimi i sotëm i Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim është rezultat jo vetëm i njerëzve që janë për momentin të angazhuar në institucione, por mbi të gjitha është sukses i qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët jo vetëm nga viti 2003, kur për herë të parë në Samitin e Selanikut u konfirmua perspektiva evropiane e Kosovës, por qysh nga vitet e '90-ta, në kohën kur ky popull udhëhiqej nga presidenti Rugova, në çdo takim të rëndësishëm ndërkombëtar konfirmohej se populli i Kosovës është i orientuar nga Perëndimi, se populli i Kosovës e dëshiron integritetin euroatlantik, se populli i Kosovës assesi nuk e dëshiron orientimin nga Lindja.

Prandaj, hapi i sotëm, nënshkrimi i MSA-së, në radhë të parë, dhe tani edhe ratifikimi nga ky Kuvend, shënon zhvillimin më të rëndësishëm të viteve të fundit, por është vetëm hap i parë në një proces jashtëzakonisht të gjatë për integritetin në Bashkimin Evropian, sepse më në fund, pas retorikës së gjatë dhe të thatë, që nga viti 2003, në Samitin e Selanikut, e kemi një hap konkret, e kemi një karotë nga Bashkimi Evropian. Kjo në fakt është karota e vetme që e morëm qysh nga viti 2011 kur filloi procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe shpresojmë shumë që ajo të tjetra, të cilën e meriton populli i Kosovës, të jetë liberalizimi i vizave.

Pse sot Kosova po e ratifikon një dokument, i cili nuk e karakterizon si entitet, jo shtet, siç e dëgjuat, por e karakterizon si shtet. Po i përmendi disa arsye:

Ndër pyetjet më themelore që delegacioni i Republikës së Kosovës ka pasur për vite me radhë gjatë negociimit të MSA-së ka qenë, në qoftë se do të kategorizohemi te shtetet të cilave u ofrohet instrument i bashkëpunimit si entitete jo shtete, apo Kosovës do t'i ofrohet marrëdhënie e stabilizim asociimit si marrëdhënie kontraktuale me BE-në, e njëjtë me shtetet e rajonit. Ajo që ne sot po e ratifikojmë është kjo e dyta. Pra, po ratifikojmë një marrëdhënie kontraktuale që hap

mundësinë e anëtarësimit, në qoftë se kuptohet, në ndërkohë arrijmë edhe njohjet e pesë shteteve, të cilat nuk na kanë njohur deri më tani.

E dyta, përfshirja në preambulë e fusnotës, e cila i referohet edhe Rezolutës 1244, edhe opinionit këshillëdhënës të GJND-së, assesi nuk nënkupton që ne sot po e ratifikojmë një dokument që, siç u tha, po e karakterizua Kosovën si pjesë autonome të Serbisë. Pse? Vetë mendimi i GJND-së e ka konfirmuar që Rezoluta 1244 e ka paraparë juridiksionin e Jugosllavisë në Kosovë vetëm e vetëm për një periudhë të përkohshme deri në momentin e përcaktimit të statusit final. Lexojeni paragrafin 11.e dhe 11.f të kësaj rezolute. Në momentin kur përfaqësuesit e popullit kanë determinuar se cili është ai status final, pra pavarësia, ka përfunduar regjimi juridik i Rezolutës 1244, i cili parasheh juridiksion të Jugosllavisë.

Çdo gjë që ka ndodhur pas 17 shkurtit 2008 e konsideron Kosovën si shtet të pavarur dhe këtë e konfirmon edhe opinionin e GJND-së. Pra, përfshirja e këtyre të dyjave nuk nënkupton që sot po e ratifikojmë një dokument që e konsideron Kosovën pjesë të Jugosllavisë, por dokument që e konsideron Kosovën si Republikë të Kosovës.

Për më tepër, edhe baza ligjore që u përmend më herët, pra neni 218 i Traktatit të Lisbonës tregon se sot Kosova po trajtohet sikur shtetet tjera të rajonit.

Në qoftë se e shikojmë preambulën e MSA-së, thuhet që këtu po ndërmerren hapa konkretë për perspektivën evropiane të Kosovës, në përputhje me perspektivën e rajonit, dhe të gjitha shtetet tjera të rajonit konsiderohen si shtete sovrane, e jo si entitete jo shtete.

Dhe, po ashtu, thuhet që Kosova duhet t'i përmbushë kriteret e Kopenhagës të vitit 1993, që po ashtu janë kriteret që kanë të bëjnë me shtete të pavarura dhe sovrane.

U tha më herët nga ministri se Bashkimi Evropian i para dhjetë vjetëve dhe pesë vjetëve nuk është ai i sotmi dhe kjo e sqaron pse sot MSA-ja që ne po ratifikojmë është më ndryshe në disa nene se sa të tjerat, sepse Bashkimi Evropian funksionon në bazë të parimit të mësimave të mësuara, apo “lessons learned”, që i quajnë ata.

Kroacia ka ratifikuar dokumente të ndryshme nga ato që i kanë ratifikuar Bullgaria dhe Rumania, sepse në ndërkohë, bazuar në mësimet e reja dhe dështimet kanë paraqitur kushtet të reja, dhe përderisa Serbia nuk e ka nenin 2, nuk e ka pasur në MSA, të mos harrojmë që Serbia e ka kapitullin 35 për ta negociuar, që po ashtu do të kërkojë njohje të kufijve dhe njohje, edhe pse në mënyrë indirekte, të shtetit të pavarur të Kosovës.

U tha që MSA-ja sot që po ratifikohet nuk mund të konsiderohet si sukses historik. Pavarësisht epiteve të tilla, mendoj që Republika e Kosovës i ka pasur vetëm dy zgjidhje.

E para ka qenë që të mos e nënshkruajë MSA-në, sepse nuk i pëlqen neni 2, dhe të presë deri në njohjen e pesë shteteve të fundit që kanë mbetur. Ky ka qenë opsioni.

Dhe e dyta ka qenë që ta nënshkruajë MSA-në dhe ta ratifikojë sot shpresoj dhe në ndërkohë t'i ndërmarrë të gjitha reformat e kërkuara në këtë dokument dhe të punojë në ndërkohë shpresojmë në njohjen nga pesë shtetet, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën.

Besoj që qytetarët e Republikës së Kosovës do ta zgjidhnin të dytën, pra jo të stagnojnë dhe të presin që të ndryshojë neni 2, pas njohjeve të pesë shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, por ta nënshkruajnë MSA-në dhe në ndërkohë të punojnë edhe për këto pesë shtete.

Dhe, e fundit, te neni 2 e kemi një tekst, i cili thotë se “asnjëri nga termat e përdorur nuk përbën njohje të Kosovës nga shtetet anëtare që nuk e kanë ndërmarrë një hap të tillë”. Pra, neni 2 po u referohet vetëm pesë shteteve, kolegë të nderuar, nuk u referohet 28 shteteve. Ky nen po e konfirmon që 23 shtete e kanë njohur, por 5 nuk e kanë njohur. Pra, nuk është që po konsiderohet se tërë BE-ja paska status neutral ndaj statusit të Kosovës, sepse njohja është akt bilateral politik, nuk është që duhet të presim njohje nga BE-ja si e tillë. Njohjet janë individuale, janë bilaterale nga secili shtet veç e veç, dhe ky nen me gjithë faktin që flet për ato pesë shtete që ende se ka njohur, po ashtu konfirmon që ekziston një shumicë që në momentin e ratifikimit të sotëm do të konsideroj se ka nënshkruar marrëveshje me një shtet të pavarur dhe sovran.

Po e përmbyll me çështjen të cilën e fillova. Pra, ky është një sukses i qytetarëve të Kosovës, të cilët sot, në qoftë se asgjë tjetër, kanë pritur që të gjithë të qëndrojmë në sall. Në qoftë se asgjë tjetër kanë pritur unitet politik për një çështje që e prek jetën e tyre, interesin e tyre dhe, në qoftë se asgjë tjetër, sot ndihen të zhgënjyer. Të zhgënjyer me këtë dështim që nuk u arrit një unitet politik për një çështje kaq të rëndësishme dhe e kam thënë edhe më herët që, pavarësisht sukseseve historike e johistorike, në qoftë se ne nuk jemi të gatshëm këtu të dëshmojmë se mund të bëhemi bashkë kur preket jeta e qytetarëve, atëherë vërtet nuk e meritojmë të bëjmë asnjë hap më tutje në procesin e integritimit evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuar presidente e Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër, ministra, deputetë,

Marrëdhëniet kontraktuale, të vendosura para pak ditësh, por që sot do të ratifikohen këtu në Kuvendin e Kosovës ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, është një arritje jashtëzakonisht e madhe për Kosovën. Ata që nuk e shohin këtë, me të vërtetë mbajnë syze të errëta.

Ndryshe nga Iliri, i cili për këtë proces duket se ua dha meritën disa individëve, unë do t'u jepja ca merita edhe institucioneve të Kosovës. Do ta veçoja, përveç Qeverisë, edhe Kuvendin. Të mos harrojmë që Kuvendi i Kosovës ka vite që miraton ligje, bën punë parapërgatitore shumë të vlefshme, ligje të cilat janë në përputhje me ligjet e Bashkimit Evropian, ose së paku i përafron ato, gjë që është një punë jashtëzakonisht e rëndësishme parapërgatitore.

Ajo çfarë dua të them unë sot lidhet me modelin BE. Modeli BE i ka disa parime jashtëzakonisht të rëndësishme, mund të themi është modeli më i mirë në botë.

Këto parime janë, e këtë duhet ta dinë të gjithë qytetarët e Kosovës, por edhe vendimmarrësit: regjim demokratik, këtu nuk ka alternativë, as ndonjë regjim anarkist, as totalitar, as autotarist, po them vetëm demokratik.

BE nënkupton respektim të lirive dhe të të drejtave të njeriut. BE nënkupton sundim të ligjit. Nuk ka negociata në këtë çështje. BE nënkupton fqinjësi të mirë me vendet e rajonit. Ky është parimi mbi të cilin është formuar BE-ja. BE nënkupton zhvillim ekonomik. Me një fjalë, për të gjithë ata që e kuptojnë, BE nënkupton transformim të brendshëm të një vendi, të një shoqërie dhe për ta bërë këtë transformim të brendshëm nuk mjafton vetëm vullneti politik i politikanëve, i cili është jashtëzakonisht i nevojshëm, por duhet edhe një vetëdije shumë e lartë e vetë qytetarëve të atij vendi dhe duhet edhe angazhimi i tyre për ta bërë këtë transformim të mundur dhe për t'iu afruar pra modelit të BE-së.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit nënkupton edhe negociata të vështira dhe të komplikuar, do të thosha, për secilin produkt, sepse në radhë të parë këtu kemi të bëjmë me ekonominë. BE është bashkëpunim ekonomik dhe kjo do të ndodhë edhe ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Për këtë duhet angazhim i ekspertëve më të mirë që ka Kosova dhe unë këtu dua t'i bëjë thirrje Qeverisë që këtë gjë ta marrë me shumë seriozitet, pasi negociatat do të jenë jashtëzakonisht të komplikuar.

Unë propozoj që Qeveria e Kosovës të bashkëpunojë ngushtë me Republikën e Shqipërisë, të mësohet nga eksperiencia e tyre, por edhe gabimet e tyre, në mënyrë që të mos përsëriten.

Për sa i përket statusit të Kosovës si shtet përballë BE-së, në këtë marrëveshje është e qartë se pesëshja e shteteve që nuk e njeh Kosovën e bën këtë marrëveshje pak më të ndryshme se ajo që e kanë nënshkruar vendet e tjera të rajonit. Ky nuk është lajm, sado që mund të theksohet nga dikush. Në këtë gjë e dimë shumë mirë. Pesë vende në BE nuk ka njohin dhe kjo e komplikon çfarëdo lloj marrëveshjeje, e cila mund të nënshkruhet nga BE si entitet me Kosovën.

Por, siç e thashë më herët, pavarësisht nga kjo situatë politike, nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje dhe plotësimi i standardeve nënkupton transformimin e brendshëm. Në jemi futur tashmë në një rrugë dhe rruga është drejt Bashkimit Evropian, derisa të mbërrijmë te portat e BE-së, por do të jetë shumë e qartë - atë ditë që porta e BE-së do të hapet për Kosovën, ne aty mund të hyjmë vetëm si shtet i barabartë me shtetet e tjera. Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Shtetësia nuk mund të negociohet. BE është bashkim shtetesh, prandaj ne nuk kemi si të anëtarësohemi ndryshe. Më duhet ta shfrytëzoj foltoren e Kuvendit për t'u bërë edhe një thirrje zyrtarëve më të lartë të Bashkimit Evropian: për liberalizimin e vizave Kosova është i vetmi shtet në rajon që nuk ka përfituar nga ky proces dhe qytetarët e Kosovës nuk e meritojnë izolimin, për më tepër që rrethohen nga qytetarë të vendeve të tjera që përfitojnë nga ky proces. BE-ja duhet ta marrë shumë seriozisht, por edhe me pak zemërgjerësi çështjen e liberalizimit të vizave, sepse ju garantoj që izolimi nuk është në të mirë as të institucioneve, as të qytetarëve, dhe nuk kam dëshirë që dikush, sidomos rinia, të vendosë ndonjë pikëpyetje në raport me drejtimin tonë pro BE dhe pro perëndimor. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj profesorin Muhamet Mustafa që ta marrë fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Unë e kisha përgatitur një diskutim për të folur pak për sfidat, por mendoj se kemi kohë dhe ne do të përballohemi me këto sfida që janë të rënda dhe e kërkojnë një nivel më të lartë të përgjegjësisë dhe unë nuk po shoh se këtu në sallë kemi shumë dilema lidhur me votimin për këtë marrëveshje.

Mendoj se është një nder i madh për ne si deputetë dhe si kredi e madhe për këtë Qeveri që ne sot kemi ardhur në këtë fazë që ta votojmë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Iliri i përmendi disa nga pionierët që kanë punuar në këtë punë, por mendoj se ne duhet ta japim një kredi dhe një falënderim edhe Qeverisë së sotme, për shkak se në kushte shumë më të vështira politike me të cilat po ballafaqohemi, të imponuara nga një pjesë e spektrit politik, ka arritur ta përmbyllë këtë. Në këtë drejtim pra janë të shumtë aktorët që sot duhet të përmenden, nuk mund t'i përmendim të gjithë, por gjithsesi ky është një moment shumë i rëndësishëm. Thashë që ne kemi sfida që ta ndërtojmë rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe ekonominë konkurruese, dy kritere kryesore bazike për integrimin e Kosovës në BE, por për to duhet të flasim, e më shumë se të flasim duhet të punojmë shumë vitet e ardhshme.

Unë shpresoj thellë që edhe pjesa tjetër e spektrit politik do të bashkëngjitet në këto përpjekje të vështira që duhet t'i bëjmë në të ardhmen dhe t'i evitojmë kontradiktat se ne jemi për Evropë, jemi për integrim, jemi për MSA, në anën tjetër ne e lëshojmë sallën, ne e pamundësojmë punën e Kuvendit. Më lejon të konstatoj se kjo është një kontradiktë. Ata e përmendën sot edhe marrëveshjen për Asociacionin, edhe për demarkacionin mund të kenë shqetësime legjitime, por mënyra se si po i shprehin ato shqetësime është antievropiane.

Prandaj, unë i ftoj që të bashkëngjiten në Kuvend, të mundësojnë funksionimin e Kuvendit dhe të bashkohen me ne që ta krijojmë masën kritike për ndryshimet, të cilat duhet t'i bëjë kjo shoqëri. Faleminderit zoti kryetar dhe deputetë dhe unë me kënaqësi të madhe ju ftoj që ta votojmë këtë marrëveshje.

KRYETARI: Faleminderit! Luljeta Veselaj-Gutaj është deputetja e fundit që e ka kërkuar fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

E nderuara presidente e Republikës së Kosovës,

Rëndësia e nënshkrimit të MSA-së për Kosovën është akt historik. Me nënshkrimin e MSA-së, Kosova e bëri hapin e parë më të rëndësishëm drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, e bëri progresin më të madh politik dhe historik në rrafshin ndërkombëtar drejt rrugës së integritimit në familjen evropiane, drejt vlerave evropiane dhe transatlantike. Pakontestueshëm është meritë dhe dëshmi e suksesit të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe e gjithë qytetarëve të vendit.

Ky angazhim dhe përkushtim serioz i institucioneve të Republikës së Kosovës është dëshmia më e mirë drejt realizimit të synimeve dhe prioriteteve në proceset integruese që do të sjellin përfitime ekonomike, gjeostrategjike e politike në raport me vendin tonë. Sigurisht që gjatë këtij procesi dhe të gjitha proceseve tjera integruese, Kosova pa dyshim që do të hasë në vështirësi nga politikat kundërshtuese joaleate, por që nga çlirimi i vendit tonë, synimi, orientimi apo rreshtimi ynë si shoqëri ka qenë dhe është integrimi në vlerat evropiane dhe transatlantike dhe ja ky është vetëm fillimi i realizimit të synimeve tona. Ky është akt përfitimi nga kjo marrëveshje kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe garantues aleatët e implementimit të kësaj marrëveshjeje.

Në kontekstin politik, po e ritheksoj se është akt historik për vetë faktin se nga tash e tutje Kosova me Bashkimin Evropian kanë vendosur raporte kontraktuale. Ne si shtet kemi vërë gurthemelin për obligimet dypalëshe që deri më tani kanë qenë inekzistente. Gjithashtu, duhet marrë parasysh dhe shumë pozitive këtë qasje të BE-së pa e përjashtuar asnjë shtet të Bashkimit Evropian për të cilin mund të nënkuptojmë apriori se edhe ato vende që ende nuk e kanë njohur Kosovën kanë filluar të mendojnë ndryshe për shtetin tonë të ri.

Përfundimisht, miratimi i kësaj marrëveshjeje nga BE-ja është esencial. Institucioneve të Kosovës u mbetet që të punojnë shumë drejt rrugës së integritit në BE. Sa më shumë që do të punojmë, aq më tepër do të përmbushen obligimet, të cilat dalin nga kjo marrëveshje. Kosova asnjëherë më shumë s'ka pasur nevojë që të ketë institucione stabile dhe unike rreth konsolidimit të shtetësisë. Anëtarësimi i Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare si procese të domosdoshme dhe si obligime që ia kemi vendosur vetes si shoqëri, vetëm sa e forcojnë subjektivitetin tonë ndërkombëtar.

Sot është një ditë e madhe për Kosovën, sepse Kosova e filloi një epokë të re. Andaj, me këtë rast - përgëzime për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka deputetë të tjerë të paraqitur? Bekim Haxhiu, përgatitet ministri i Integritimeve se s'ka tjetër deputetë.

BEKIM HAXHIU: E nderuar presidente,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Normalisht që një moment i tillë, i veçantë, neve si deputetë na e jep edhe privilegjin dhe kënaqësinë që ta diskutojmë këtë moment historik për Republikën e Kosovës, për çdo qytetar pa dallim përkatësie politike dhe partiake. Do të doja që vërtet ky debat sot për MSA-në të jetë më shumë pjesëmarrës, më gjithëpërfshirës dhe në veçanti duke falënderuar edhe deputetët paraprakë, që e filluan debatin dhe diskutimet për MSA-në, dhe të mos përfundonte vetëm në nivelin e shefave të Grupeve të Parlamentare.

Sot Kosova po e rifillon një epokë të re kontraktuale me organizatën super-nacionale Bashkimin Evropian, në kontinentin tonë të vjetër, ku për breza i kemi aspiruar vlerat e civilizimit dhe të demokracisë dhe kualitetit të jetës më të mirë për çdo qytetar. Kjo ditë e madhe për Kosovën nuk ka arritur sigurisht vetvetiu, nuk ka ardhur dhuratë prej askujt dhe është mund dhe përpjekje e

sakrificës së shumë brezave, e familjeve të mëdha patriotike, intelektuale të të gjitha gjeneratave, e sidomos e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, që e bëri kthesën historike të atdheut tonë dhe nga një okupim klasik e nxori këtë vend në rrugën e lirisë, të cilën tash po e gëzojmë dhe po e fillojmë me integrimin evropian, në Evropën demokratike. Janë këto vlera që sot duhet të mos na ndajnë, por të na bashkojnë. MSA-ja është një konfirmim i njohjes së Kosovës si anëtare aspirante për t'u bërë edhe formalisht candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Unë nuk do të flas për aspektin ekonomik dhe aspektet e politikave ekonomike të MSA-së, për arsye se këtë do t'ua lë ekspertëve të fushës, të cilët do të diskutojnë më me kompetencë, por si deputet, në aspektin politik dhe juridik, ratifikimi i MSA-së në Kuvendin e Kosovës është një ngjarje historike për këtë legjislaturë.

Andaj, duhet të ndihemi të privilegjuar që kemi arritur dhe ne jemi ata që do ta ratifikojmë këtë marrëveshje. Besoj se edhe në zemrat dhe mendjet tona do t'i lëmë anash betejat partiake e politike dhe do ta votojmë Ligjin për ratifikimin e MSA-së. Dhe, krejt në fund, duke mos e zgjatur më shumë, të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës ua urojmë këtë moment të veçantë dhe të rëndësishëm për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bekim Çollaku, ministër i Integriteteve Evropiane, e ka fjalën.

BEKIM ÇOLLAJU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E mora fjalën vetëm për t'iu falënderuar të gjithë juve që jeni të pranishëm, për fjalët tuaja dhe për përkushtimin ndaj procesit të integritetit evropian.

Do të doja ta kisha mundësinë që kritikën që u adresuan në përmbajtjen e MSA-së nga partitë opozitare të merrnin përgjigje adekuate nga unë, mirëpo, fatkeqësisht, ata nuk janë këtu dhe unë s'kam si t'u jap përgjigje, e nuk kam vend tjetër, përveç këtij, ku mund t'i jap përgjigje çdo shqetësimi, jo vetëm të tyre, por të kujtdo qoftë.

Sidoqoftë, kishte deputetë, siç ishte Vjosa, që u dhanë përgjigje të gjitha atyre shqetësimeve ligjore që ata i paraqitën më herët dhe unë s'kam pse t'i ripërsëris edhe një herë.

Ky është një moment i veçantë dhe në mëngjes, kur e filluam këtë seancë, dukej si i tillë. Mirëpo, fatkeqësisht, mosprania e opozitës e zbeh këtë moment të veçantë. Opozita dhe të gjithë ju, të nderuar deputetë, duhet ta keni të qartë që ta përmbushni rolin dhe obligimin tuaj që e keni karshi qytetarëve të Kosovës për ta shpënë Kosovën sa më afër integritetit në Bashkimin Evropian.

Mungesa e partive opozitare sot, përjashtoi deputetin e nderuar zotin Deda, dhe mungesa e gazit lotsjellës nuk është e nevojshme për ta çuar Kosovën përpara. Kështu që ka kontradiktë të mëdha ndërmjet deklaratave politike të partive opozitare sa i përket procesit të integritetit evropian dhe veprimeve konkrete. Mirëpo, janë qytetarët e Kosovës ata që më së miri do t'u gjykojnë edhe ju që jeni të pranishëm këtu, edhe ata të cilët nuk janë të pranishëm. Do të jetë koha ajo që do të dëshmojë se kush ka pasur të drejtë dhe kush ka bërë gabim të rëndë.

Kështu, ju falënderoj për praninë tuaj dhe kërkoj votën tuaj për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër!

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Isa Mustafa, ta marrë fjalën para votimit.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

E nderuar Presidente e Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Mendoj se është një ditë shumë e madhe për ne sot, sepse kemi të bëjmë me një dokument tepër të rëndësishëm për Kosovën. U tha edhe më parë, është fjala për një dokument i cili sipas rëndësisë së tij është në piedestalin e marrëdhënieve tona me Bashkimin Evropian të ndërtimit të urave lidhëse me BE-në dhe të përplotësimit të kushteve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Unë dëshiroj kësaj radhe të mos flas për rëndësinë e marrëveshjes, sepse një gjë e tillë është shumë e njohur për ne dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, por para së gjithash t'i falënderoj të gjithë ata që kanë punuar deri më sot në këtë marrëveshje.

E falënderoj Bashkimin Evropian dhe të gjitha vendet e Bashkimit Evropian për përkrahjen dhe angazhimin e tyre gjatë gjithë kësaj rruge në sqarimin e të gjitha pikave të kësaj marrëveshjeje. I falënderoj të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe në rend të parë Kuvendin e Republikës së Kosovës në të gjitha mandatet, sepse janë deputetët ata që e kanë përcjellë në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet vendimeve të tyre, ligjeve që i kanë aprovuar këtu, progresin tonë në përplotësimin e kushteve që para nesh i ka shtruar Bashkimi Evropian, Qeverinë e kaluar dhe këtë Qeveri për punën që ka bërë dhe të gjithë individët, edhe Presidenten e Republikës së Kosovës, sepse është angazhuar me përkushtimin më të madh në këtë proces.

Ky proces është tepër i rëndësishëm për ne në krijimin e shtetit ligjor, në krijimin e kushteve për zhvillim më të mirë ekonomik dhe të ndërlidhjeve ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian, sepse kemi të bëjmë me një treg prej më shumë se 500 milionë banorëve, që është një treg krejtësisht i ri, që ofron cilësi krejtësisht tjera për ekonominë tonë dhe për mundësitë tona tregtare dhe ekonomike. Është një marrëveshje e cila na mundëson cilësi tjetër të demokratizimit të vendit dhe të kyçjes së të gjithë qytetarëve tanë, pa marrë parasysh etninë, pa marrë parasysh fenë, pa marrë parasysh orientimin e tyre politik, në një front të përbashkët të angazhimit tonë karshi Bashkimit Evropian dhe me Bashkimin Evropian.

Unë pres që të gjithë ne do ta votojmë, ashtu siç u propozua sot në Kuvend, Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, si një dokument tepër i rëndësishëm sot për ne. Nuk shtrohet pyetja se çfarë është Kosova, ajo është e qartë për të gjithë ne. Nuk shtrohet pyetja se cili është relacioni i Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, sepse është shumë i qartë me këtë marrëveshje për ne, por shtrohet pyetja që ne duhet t'i plotësojmë në të ardhmen të gjitha kriteret të cilat i kemi pranuar me këtë marrëveshje si kontratë, që po e bëjmë me Bashkimin Evropian.

Është një kontratë shumë e rëndësishme për ne. Ne duhet të punojmë me të gjithë qytetarët tanë. Duhet të punojmë me të gjitha institucionet tona. Duhet të punojmë me ekonominë, duhet të punojmë me shoqërinë civile, sepse të gjithë së bashku e kemi vendin në realizimin e saj. Fryma e marrëveshjes është frymë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë treguar orientimin e tyre proevropian. Ata janë përcaktuar që vendi ynë është në Evropë dhe kjo marrëveshje siguron që ne ta sendërojmë vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po ashtu, e përsëris se pas kësaj marrëveshjeje ne na mbeten deri në fund të këtij viti edhe dy çështje tepër të rëndësishme, është ajo që së bashku me zëvendëskryeministrin zotin Thaçi dhe njëherësh ministër i Punëve të Jashtme po punojmë shumë në anëtarësimin tonë në UNESCO, që është një hap shumë i madh që duhet ta bëjmë dhe është ajo që presim nga Bashkimi Evropian që të caktohet data e liberalizimit të vizave, që mendoj se është një meritë jona dhe do të jetë meritë edhe e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Ndërkohë, tashmë jemi në procesin para votimit. Në bazë të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3-ve të të gjithë deputetëve i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare.

Pra, ratifikimi i marrëveshjes kërkon së paku 80 vota për, ndërsa në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 60, paragrafi 3, procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Ju lus që regjia t'i bjerë ziles, që të mblidhen deputetët, se i kemi 81 deputetë. Faleminderit për mirëkuptim!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Procedurat juridike për vendimmarrje i lexova. Tash do të procedojmë me votimin.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e amendamenteve dhe projektligjit, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 87 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Atëherë vazhdojmë me votimin e amendamentit, të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL për Integritet Evropian.

Amendamenti 1

Kush është për?

Kush është kundër? Nuk ka!

A abstenon ndokush?

Atëherë, për janë gjithsej 85.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e ligjit në tërësi. Në sallë jemi 87 deputetë.

Jemi duke e votuar ligjin në tërësi. Votojmë tash!

Urime të gjithë qytetarëve dhe deputetëve të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se me 86 vota për, Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës, në njërën anë, Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

Urime edhe një herë! Me këtë i mbyll punimet e sotme të seancës plenare! Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*